



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT**

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2026 dhe PBA Pëfundimtare 2026-2028”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetet në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8, 9, 41, 54/dh, 64/c, ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 6, pika ç, d, 39,40 41, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, ligjit 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 65, pika 1, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328 datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ligjit 93/2024 “Për një ndryshim në ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë minimale”, Vendimin nr. 422, datë 26.06.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 93, datë 28.12.2021, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Berat”, i ndryshuar, Vendimit nr. 540, datë 21.12.1992, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillave të kulturës dhe shpërblimin e tyre”, I ndryshuar, Udhëzimit nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillave Artistiko – Kulturor”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2026-2028”, Udhëzimit Plotësues nr. 19 datë 10.07.2025 “Për përgatitjen e PBA Vendor 2026-2028”, dhe shkresës së Ministrisë së Financave, nr. 15876 datë 06.11.2025 “Dërgohet për njoftim transfera e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale për vitin 2026”,

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjecare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

1.1. **Situata financiare :** (Plani i të ardhurave të Bashkisë Berat për periudhën 2026 - 2028, në vlerat si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vlerat paraqiten në: ALL

Lloji i të Ardhurave		2026	2027	2028
		Plani	Plani	Plani
A	Të Ardhura nga Burimet e Veta	646,483,000	651,975,000	656,747,000
A.1	Të Ardhura nga Taksat dhe Tarifat Vendore	582,809,000	586,391,000	589,195,000
A.2	Të Ardhurat nga Taksat e Ndara	63,674,000	65,584,000	67,552,000
B	Transferta nga Buxheti Qendror	1,012,830,674	1,051,942,559	1,086,804,887
B.1	Transferta e Pakushtëzuar e Përgjithshme (përfshirë transf.për rritjen e pagave)	611,514,899	650,626,784	685,489,112
B.2	Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	401,315,775	401,315,775	401,315,775
C	Grante të Huaja	3,505,918	6,889,654	650,781
C.1	Grante të Huaja	3,505,918	6,889,654	650,781
Total të ardhura/burime buxhetore (A+B+C)		1,662,819,592	1,710,807,213	1,744,202,668

1.1.Plani i shpenzimeve të Bashkisë Berat për vitin 2026 dhe periudhën 2026 – 2028
, në vlerat si më poshtë:

Vlerat paraqiten në: ALL

Kategoria e Shpenzimeve		2026	2027	2028
		Plani	Plani	Plani
1	Shpenzime Personeli (600-601)	956,572,000	966,136,000	975,800,000
2	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	506,971,191	530,715,191	543,108,441
3	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	195,770,483	207,066,368	224,643,446
4	Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja)	0	0	0
5	Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)	3,505,918	6,889,654	650,781
6	Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)	0	0	0
Totali i Shpenzimeve		1,662,819,592	1,710,807,213	1,744,202,668

Drejtoria / Sektori përgjegjës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria e Bashkisë Berat dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të saj.

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Drejtoria e Bashkisë Berat dhe Njësitë Shpenzuese në varësi të saj janë kryesore në monitorimin do të përgatisin raportet e monitorimit përkatëse sipas periudhave 4 mujore, 6 mujore, 8 mujore dhe vjetore sipas udhëzimeve përkatëse për monitorimin e projekt-buxhetit

Impakti social / grupet që preken:

Plan buxheti i vitit financiar 2026 dhe PBA 2026-2028 krijon mundësi për të patur një ecuri të shëndetshme të financave të dhe për t'i shërbyer qytetit në zhvillimin e tij.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky buxhet reflekton dhe kërkesat e bëra nga qytetarët në 7 dëgjesat e zhvilluara për buxhetin 2026 dhe PBA 2026-2028

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 21/12/2025, shqyrtoi projekt vendimin “**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË**

BASHKISË BERAT PËR VITIN 2026 DHE PBA PËRFUNDIMTARE 2026-2028”

relacionin e dokumentat shoqërues propozuar nga Kryetari i Bashkisë dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI

- a. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:
- b. Miratimin e detajimit të buxhetit të vitit 2026, sipas Tabelave të Buxhetit Vjetor 2026, pjesë përbërëse e këtij vendimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

- c. Miratimin e raporteve të buxhetit afatmesëm 2026-2028, sipas Tabelave të PBA 2026-2028, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- d. Miratimin e numrit total të punonjësve për vitin 2026 të bashkisë Berat : 816 punonjës për 6 njësi shpenzuese, nga të cilët numri i strukturës së Policisë Bashkiake është 17, sipas listës së njërive shpenzuese, tabela pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- e. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të këshillit bashkiak në masën 10 % të pagës së kryetarit të bashkisë.
- f. Miratimin e shpërblimit mujor të kryetarëve të fshatrave në masën 6 % të pagës së kryetarit të Bashkisë.
- g. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të këshillit artistiko-kulturor me 4,500 lekë çdo muaj kur zhvillojnë mbledhje. sipas përcaktimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
- h. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të Grupit të këngës popullore , të Orkestrës Simfonike, të Bandës Frymore, në Qendrën Kulturore “Margarita Tutulani” me 7,000 lekë/muaj.
- i. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të Asambllit të Valles, të Artit Skenik , në Qendrën Kulturore “Margarita Tutulani” me 5,000 lekë/muaj.
- j. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave të depozitojë pranë Degës së Thesarit Berat buxhetin e vitit 2026 të detajuar sipas udhëzimeve përkatëse.
- k. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen drejtoritë e bashkisë Berat dhe njësitë shpenzuese në varësi të saj.
- l. Vendimi hyn në fuqi në datën 1 janar 2026.

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Anisa Veliu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 21 /12/2025